



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më, 05.07.2018

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË QËLLIMIT, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR INSTALIMIN DHE PËRDORIMIN E SISTEMIT PËR KRAHASIMIN DHE VLERËSIMIN E SIGURT TË IDENTIFIKIMIT PERSONAL (PISCES)”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.07.2018 shqyrtoi projektligjin “*Ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)*”, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin: Renata Balliu, Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit: Z. Ernest Dimashi, Z. Ylli Kumria; Z. Zyhdhi Mema

2.0 Nisma ligjvënese

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënësë të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78, 83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbatja e projektligjit

Memorandumi, midis dy qeverive asaj të Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka si qëllim të instalojë Sistemin për Krahësimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), për monitorimin e lëvizjes së udhëtarëve në pikat e kontrollit kufitar që do të përcaktohen bashkërisht nga palët. Sipas përmbatjes së memorandumit, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të instalojë dhe do të mirëmbajë të gjitha pajisjet elektronike të nevojshme për funksionimin e sistemit PISCES, duke filluar në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës e më pas sistemit PISCES do të zgjerohet edhe në aeroporte apo pika të tjera kufitare, të caktuara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Memorandumi është miratuar në parim me vendimin nr.479, datë 28.6.2017, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar në datën 22 mars 2018.

Instalimi i sistemit (PISCES) do të shtojë disa elemente sigurie të kontrollit në pikat e kalimit kufitar. Elementi kryesor është ai i të dhënave biometrike të cilat do të identifikojnë edhe raste të vështira për t'u zbuluar nëpërmjet sistemit aktual. Gjithashtu, instalimi i këtij sistemi do të shoqërohet me një rinovim të infrastrukturës, duke pajisur çdo punonjës me kompjuter, lexues dokumentesh, lexues gjurme gishti, kamera për kontrollin e fytyrës. Këto të dhëna do të krahasohen me regjistrat e Interpolit dhe të FBI-së, duke na dhënë një përparësi në zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar në nivel ndërkombëtar

Për këtë arsye në memorandum është parashikuar që përzgjedhja e personelit që do të operojë me sistemin PISCES të bëhet nga qeveria Shqiptare, dhe konkretisht nga Ministria e Brendshme, ndërsa trajnimi i tyre ,krijimin e kapaciteteve të kualifikuara, do të realizohet nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sistemi do të shërbejë për përmbushjen e një ndër objektivave të Ministrisë së Brendshme, sigurimin e menaxhimit të integruar të kufijve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të garantuara si për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen për zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar ndërkombëtarisht. Të dyja qeveritë synojnë të bashkërendohen përpara çdo transferimi apo zhvendosjeje të mjeteve

dhe pajisjeve kompjuterike të PISCES.

Sipas përmbajtjes së memorandumit pikat e kontaktit do të jenë:

Për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, ministri i Brendshëm ose çdo person i caktuar nga ministri;

Për qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri ose çdo person i caktuar nga Ambasadori.

4.1 Përmbajtja e projektligjit

Projektligji përmban dy nene në të cilët parashikohet:

Neni 1, përcakton ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahësimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Në nenin 2 është përcaktuar hyrja në fuqi e projektligjit.

5.0 Efektet financiare për zbatimin e buxhetit

Të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit “PISCES” do të sigurohen nga Qeveria e SHBA-ve, duke u përjashtuar nga taksa e TVSH-së dhe detyrimet doganore.

6.0 Diskutimet në Komision

Pas prezantimit nga të ftuarit, kryesisht të të rejave që sjell kjo marrëveshje, deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e marrëveshjes. Ata nënvizuan se kjo marrëveshje do të sjellë edhe rritjen e sigurisë në vend, pasi implementimi i saj në 8 pika kufitare është një element shtesë kontrolli.

7.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, i cili është organi kompetent sipas përcaktimeve që i bën neni 81 i Kushtetutës së Shqipërisë. Projektligji shoqërohet dhe me relacionin përkatës sipas nenin 68 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 26; 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kreu II”Marrëveshjet Ndërkombëtare, në neni 121 i saj. Marrëveshja është hartuar, mbështetur në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” në të cilën thuhet “ 1. *Ratifikimi*

është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.

2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

a) projektligji për ratifikim;

b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;

c) vendimi i miratimit në parim;

ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;

d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;

dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Nga shqyrtimi i marrëveshjes kjo procedurës është zbatuar.

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI